



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2409 Prot.

Roskovec, më 02, 06 2020

VENDIM

NR 32 .DATË 29 . 05 .2020

**“PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË KËSHILLIT  
BASHKIAK PËR MUAJIN PRILL 2020”**

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, si dhe Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec neni 88, Këshilli i Bashkisë,

**VENDOSI :**

- 1- Miratimin e procesverbalit të mbajtur më datë 27.04.2020, në mbledhjen e Këshillit Bashkiak për muajin Prill 2020.
- 2- Ngarkohet Sekretari i Këshillit me zbatimin e këtij vendimi.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**Kadri Hyska**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

Adresa: Qendër Roskovec, Web: [www.bashkiaroskovec.gov.al](http://www.bashkiaroskovec.gov.al)

Nr. 1877 Prot.

Roskovec, më 28.04.2020

Procesverbal Nr.4

*-I mbajtur sot, date 27.04.2020, ora 10, ne mbledhjen e Keshillit te Bashkise, mbledhje e radhes. Mbledhja e sotme nuk po zhvillohet ne sallen e keshillit, por ne sallen e madhe te Pallatit te Kultures, e cila ka hapsire te mjaftueshme per ruajtjen e distances se uljes se anetareve te keshillit, ne perputhje edhe me vendimet dhe aktet normative te qeverise. Keshilltaret jane paraqitur me maska dhe dorashka. Rendi i dites se mbledhjes:*

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Shkurt dhe Mars 2020.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.
4. Raport për transparencën në procesin e vendimmarrjes nga Këshilli i Bashkisë Roskovec për vitin 2019.
5. Për dhënien e Ndhmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-31 Mars 2020.
6. Për dhënie ndihma ushqimore për familjet në nevojë për shkak të epidemisë nga COVID-19.
7. Për disa ndryshime në Vendimin Nr.105 datë 22.11.2019 “Për miratimin e Paketës Fiskale për vitin 2020”.
8. Për miratim për transferim fondesh në Buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2020.
9. Për shitjen e pronave të paluajtshme në pronësi të Bashkisë Roskovec, për familjet që kanë mbetur të pastreha për shkak të investimit për interes publik dhe përjashtimit nga procesi i legalizimit.
10. Për miratimin e projektit me objekt “Rehabilitim Urban i Bllokut Nr. 1”.
11. Për krijimin e Muzeut Vendor në Bashkinë Roskovec.
12. Rezolutë nga Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Çështjeve Sociale mbi marrjen e masave të vecanta për shkak të situatës së krijuar si rezultat i pandemisë të shkaktuar nga COVID-19.
13. Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Ora e hapjes se mbledhjes: 10<sup>00</sup>



Keshilltaret prezent ne momentin e hapjes se mbledhjes: A.Kola, K.Kuka, V.Mata, E.Çepele, L.Hoxha, L.Goga, B.Çobo, B.Kuka, D.Hoxha, K.Hyska, G.Hoxha, A.Hazizi, V.Bakaj, V.Dogani, A.Sheme, V.Stani, H.Beqiraj, B.Toska, M.Sufka.

Keshilltaret qe mungojne ne mbledhje Rrapi Hazizi dhe Tajane Kuka.

Me plotesimin e kuorumit, kryetari i keshillit hap mbledhjen. Prezent ne fillimin e mbledhjes jane 19 keshilltare. Te pranishem nga administrata e bashkise: Kryetarja Majlinda Bufi, Nenkryetari M.Goga, Dr.Juridike, Dr.Urbanistikes, P/Z/NE, P/Z/tatim-taksave, arkitektja. Te pranishem kemi edhe dy qytetare F.Kasemaj dhe D.Bakaj.

Para se te filloje me rendin, kryetari ben me dije se keshilli ka hapur ne nderfaqen e tij ne web regjistrin elektronik per konsultimin publik te projekt-vendimeve. Kishim publikuar njoftimin dhe projekt-vendimet e pikave Nr.7,9,10,11 te rendit te dites, dhe kishim vendosur adrese imeili ose me shkrese ne protokoll per mendime dhe rekomandime. Kjo eshte nje praktike qe u be per here te pare nga bashkepunimi me projektin "Bashki te Forta" dhe nga trajnimet e realizuara nga ata. Nga verifikimet tek adresa e imeilit dhe ne protokollin e bashkise nuk ka pas rekomandime apo mendime per projektet e publikuara. Theksojme se njoftimet u bene sipas rregullores se kunsultimeve publike dhe ligjit, ne web dhe rrjetet sociale te bashkise. Kryetari fillon mbledhjen. Kryetarja e bashkise i falenderon te gjithet per pjesmarrjen dhe paraqitjen me masat mbrojtese, i falenderon edhe per zhvillimin e mbledhjes online heren e kaluar.

1. Miratimi i rendit te dites se mbledhjes.

Hidhet ne votim rendi i dites me nje projekt-vendim shtese nga administrata dhe miratohet unanimisht me 19 vota pro.

2. Informacion mbi Vendimet e Keshillit te mbledhjes se muajit Shkurt dhe Mars 2020.

Sekretarja e keshillit sqaron informacionin per vendimet e miratuara ne Shkurt dhe Mars 2020. Ben me dije se te gjitha vendimet e muajit Shkurt dhe Mars jane miratuar nga Prefektura Fier.

3. Miratimi i procesverbalit te mbledhjes se kaluar te Keshillit Bashkiak.

Sekretarja sqaron proceduren qe do ndiqet ne lidhje me miratimin e procesverbaleve te mbledhjes ne vijim, ashtu sic eshte ne rregullore. Hidhet ne votim miratimi i procesverbalit te mbledhjes se muajit Mars date 27.03.2020 dhe miratohet unanimisht me 19 vota pro.

4. Raport per transparencen ne procesin e vendimmarrjes nga Keshilli i Bashkise Roskovec per vitin 2019.

Sekretarja e Keshillit lexon raportin e pregatitur per punen e kryer nga keshilli ne lidhje me vendimmarrjen dhe konsultimet publike per vitin 2019, i cili u eshte shperndare te gjithet keshilltareve.

5. Per dhenien e ndihmave ekonomike nga fondi i kushtezuar deri ne 6% per periudhen 1-31 Mars 2020.

Elmazi-a ka ndonje shtese per keta qe perfitojne nga 6%? P/Z/NE Elisi pergjigjet sipas ligjit. Bujari-ne cdo njesi aplikohet per 6%, po ne Kurjan pse nuk ka pasur? Elisi sqaron se nuk ka pasur aplikime. Hidhet ne votim projekti dhe miratohet unanimisht me 19 vota pro.

6. Per dhenie ndihma ushqimore per familjet ne nevojte per shkak te epidemise nga COVID-19.

Elmazi-nuk jane ndare qytetaret sipas njesive, sa qytetare kane perfituar ndihma ushqimore? Nenkryetari M.Goga sqaron se ne total jane shperndare rreth 600 pako nga bashkia, jane futur ne liste te gjitha familjet me ndihme ekonomike pervec atyre qe kane ndonje te ardhur. Leksi-nuk e ve ne dyshim ndihmen e tyre, por jam dakort me Elmazin, mund te na sillnit nje liste emerore si per ndihmat e bashkise dhe nga donacionet. Une kam disa familje qe nuk jane trajtuar me ndihme, ata jane te papune nuk kane asgje. Aleksander-te jete numri i familjeve si informacion, nuk

duam emra. Kryetarja e bashkise kerkon ndjese sepse listat duhet te ishin ketu, ka nje ndryshim, te atyre qe do perfitojne saktesisht akoma nuk i dim te gjitha sepse presim listat e ndihmave ekonomike. Kategoria e pare perfitojne ato familje qe jane ne skemen e ndihmes ekonomike me perjashtim te atyre qe kane nje te ardhur tjeter. Te vendimi i qeverise futen edhe ato familje qe jane te pastreha dhe qe eshte ne nevoje, te miratuar nga komisioni i strehimit. Do ti publikojme te gjitha listat e familjeve perfituese. Kategoria e dyte jane familje ne nevoje qe nuk perfitojne nga vendimi, por qe jane pare nga komisioni dhe kane perfituar nga donatoret. Jemi perseri ne te njejten situat, kjo eshte paketa e dyte qe do marin, komuniteti rom i ka mar te dyja paketat. Qeveria ka nje kerkese shume te rrepte per kete gje, qe te mos abuzohet me kete procedure. Do perfitojne ato familje sipas vendimit te qeverise, te tjeret nese ka donacione. Hidhet ne votim projekti dhe miratohet unanimisht me 19 vota pro.

7. Per disa ndryshime ne Vendimin Nr.105 date 22.11.2019 "Per miratimin e Paketes Fiskale per vitin 2020".

P/Z/Tatimeve Ditmira Goga sqaron projektin dhe ndryshimet e propozuara per miratim ne keshill. Propozojm shtyrjen e afatit te fundit te pageses te takses se tokes bujqerore dhe taksa per bizneset qe lejohen dhe nuk lejohen te ushtrojne aktivitet sipas tabelës se paraqitur. Kemi paraqitur edhe ndryshimin emertimi i tarifës se varrimit dhe nje tarife te re per zhvarrimin dhe rivarrimin sipas materialit te paraqitur. Bujari-pyet per tarifate e varrimit, kerkon sqarim. Ditmira sqaron sipas ligjit. Genci-kam 2 biznese ne nje prone? P/Z/tatimeve sqaron se nuk ka lidhje me kete gje, te kam sqaruar. Hidhet ne votim projekti dhe miratohet unanimisht me 19 vota pro ndryshimet ne Paketën Fiskale.

8. Per miratim per transferim fondesh ne Buxhetin e Bashkise Roskovec per vitin 2020.

Kryetarja sqaron se kemi miratuar nje fond ne mbledhjet e kaluara 20% bashkefinancim, por nga llogaritjet e Ministrise se Financave jemi bashki qe kemi te ardhura te larta dhe duhet te shtojme edhe 10% te fondit per bashkefinancim sipas kerkeses se Ministrise, nese nuk miratohet nga Ministria keto ngelen leket tona. Hidhet ne votim projekti dhe miratohet unanimisht me 19 vota pro sipas projektit te paraqitur. Leksi-pyet per fondet qe kemi miratuar per blerje skrepi, blerje material inerte etj. qe jane miratuar mbledhje te kaluara. Kryetarja sqaron se kane ngelur pezull nuk jane prokuruar akoma, do shikojme situaten si do vej. Po rruga e romeve nga liqeni?-pyet Leksi. Kryetarja sqaron se per kete nuk ka pengese. Nuk kemi bere blerje madhore, vetem mjetet e punes se perditshme te sherbimeve, si boja per printera, leter formati etj.

9. Per shitjen e pronave te paluajtshme ne pronesi te Bashkise Roskovec, per familjet qe kane mbetur te pastreha per shkak te investimit per interes publik dhe perjashtimit nga procesi i legalizimit.

Dr. Juridike Delina Hoxha sqaron projektin. Jane tre familje Sh. Begaj, N. Driza, F. Kasemaj te cilet preken nga projekti i rikualifikimit urban i Bllokut Nr.2. Kryetarja sqaron se ky vjen nga nje vendim qe eshte mar me para. Keto 3 familje jane perfituesit e pare ne ate godine 3 kateshe, jane edhe 2 godina qe do prishen nga rikualifikimi urban i bllokut nr.2. Pas ketij vendimi komisioni i shpronësimit do vazhdoje me procedurat e tjera ligjore per kalimin e pronesise se ketyre pronave nepermjet shitjes, me akt notarial dhe te regjistruhen sipas ligjit. Eshte kerkese emergjente per keto 3 familje te cilat dalin te pastreha nga projekti urban. Aleksander-keto tre familje tek kjo godina te jene pa qera per propozimin tim. Kryetarja-ky eshte nje proces shume i hapur, ka shume kerkues qe kerkojne strehe, por nuk ka asnje hapsire ligjore qe te falet, nuk ka procedure tjeter pervec shitjes me kosto te ulet dhe per nje periudhe te lehtesuar. Strehimi nuk perfitohet falas por sipas menyrave qe parashikon ligji, nese nuk e blejne dot mund te qendrojne me qera. Keto 3 familje u favorizuan

sepse atyre iu prishet shtepia nga projekti i bllokut urban,ata jane te paret qe do perfitojne,do kene pagese te lehtesuar dhe ne fund shtepia ngelet e tyre.Procedurat ligjore do te zbatohen pike per pike sepse kjo ndertese eshte investuar nga taksat e qytetareve.Leksi-mua Shkelqin Begaj dhe Naxhie Driza nuk me rezultojne te pastrehe,sepse ne kaluam nje kerkese per marrveshje per ndryshim varianti dhe ndertim memoriali,ne projekt shtepia ishte.Kryetarja sqaron se ajo qe ju erdhi disa mbledhje me pare ishte nje kerkese nga familja Begaj,sollen nje projekt per nje zgjidhje te bute,te ndryshonte njolla dhe te ndertohej nje memorial me financimin e tyre,qe mos tu prishej banesa.Ne momentin qe ne u kerkuam te benin financimin e memorialit ata hoqen dore,por e kishin sjelle vet ate projekt.Ne derguam ne gjykate qe nuk ka marrveshje dhe te vazhdoje procesi gjyqesor.Gjyqi vendosi te qendroje ne fuqi vendimi i aluiznit per skualifikim nga legalizimi.Moralisht ketyre u takon te pareve qe te sistemohen ne ate godine,nese e pranojne apo jo pastaj eshte ceshtja e tyre.Kryetarja sqaron se nuk u arrit marrveshja me familjen Begaj sepse nuk u qendruan kerkesave te bera.Kryetarja u tregon vendimin e gjykates administrative te vlores e cila e ka rrezuar padine e familjes Begaj.Genci-pyet per investimin e godines 3 kateshe.Kryetarja sqaron se eshte investim i bashkise.Genci-pyet edhe per familjet Latifi,Kryetarja sqaron se sot jane vetem keto 3 familjet e para,me vone do shihen familjet e tjera.Hidhet ne votim projekti dhe miratohet me 17 vota pro (3/5+4 vota pro) dhe 2 vota abstenim A.Sheme dhe L.Goga.miratohet vendimi per shitjen e pronave publike (apartamente) 3 familjeve Sh.Begaj,N.Driza,F.Kasemaj sipas materialit te paraqitur.

10.Per miratimin e projektit me objekt "Rehabilitimi Urban i Bllokut Nr.1".

Arkitektja Daniela sqaron projektin e Bllokut Nr.1 me video projektor per keshilltaret.Rruget do asfaltohen dhe trotuaret,ndricimin,do nderhyet edhe tek pjesa e fasadave te pallateve.Kryetarja e bashkise e cila eshte me profesion inxhinier e sqaron projektin e prezantuar me video projektor.I gjithë projekti eshte parashikuar me 3 nenobjekte:sistemimi i rruges se Kurjanit,do behet hapja e nje pjese parkimi,risistemimi i ndricimit dhe riasfaltimi ne kete zone.Nenobjekti i dyte eshte sistemimi i parkut te gjelbert,sistemimi i rruges nga shtepia e Ylli Dyles deri tek shtepia e Baci Isufit,do sistemohet rruga,ndricimi dhe ne nje ane trotuar.Do sistemohet e gjithë pjesa mbrapa pallateve,do hiqen te gjitha godinat informale te cilat jane shtesa te bera gjate kohes.Gjithë njerzit do kene mundesi te lidhen me parkun pa dale ne rruge.Pasazhi i kalimit nuk eshte me shume se 2 m,te kalojne kembesoret.Leksi-oberri i shkolles zvogelohet?territori i Kishes do merret i gjithi?Kryetarja sqaron me detaje projektin.Siperfaqja e shkolles nuk preket fare.Do kete ndricim tek nje pjese e unazes.Parku eshte parashikuar nje zone e gjelbert,do sistemohen godinat qe jane aty,te mos prishen por jo te kene me teper territor sec u takon.Kemi problem nje familje Borici-do mundohemi ta rregullojme.Tek pjesa qe ka Kisha ne nuk mund te nderhyjme.Nenobjekti i trete ka te beje me risistemimin e rruges nga pazari deri tek trekendeshi.Arkitektja sqaron pjesen e parkut,do kete stola,ndricim,e sqaron me detaje me gjithë elementet qe ka projekti.Do kete edhe argetim per femijet.Hidhet ne votim projekti i rehabilitimit Urban i Bllokut Nr.1 dhe miratohet unanimisht me 19 vota pro,sipas meterjalit dhe prezantimit te bere nga zyra e urbanistikes.

11.Per krijimin e Muzeut Vendor ne Bashkine Roskovec.

Kryetarja sqaron se behet fjale per godinen ekzistuese te bashkise,ne thelb jemi munduar qe te ruajme identitetin e godines,kjo eshte nje godine shume e vjeter.Ne brendesi te godines hyrja nuk do ndryshoje,pjesa e shkalleve jane spostuar ne fund te godines.Do kete holl te ndare me pavione ne varesi te modelit.Ne katin siper nje pjese do jete zyra per stafin e Muzeut .pjesa tjeter do jete pavione te ndryshme sipas modelit.Ky projekt eshte shume modern.Hidhet ne votim projekti dhe miratohet unanimisht me 19 vota pro,miratohet me 3/5 + 6 vota pro.

12.Rezolute nga Komisioni i Barazise Gjinore dhe Çeshtjeve Sociale mbi marrjen e masave te vecanta per shkak te situates se krijuar si rezultat i pandemise te shkaktuar nga COVID-19. Kete rezolute e ka propozuar Komisioni i Barazise Gjinore dhe Çeshtjeve Sociale ne bashkepunim me projektin Bashki te Forta per mbrojtjen e viktimave te dhunes ne kohën e pandemise.Kryetarja eshte shume i drejte,do marrim masa.Hidhet ne votim projekti dhe miratohet unanimitisht me 19 vota pro rezolute e Komisionit te Barazise Gjinore dhe Çeshtjeve Sociale.

13.Per dhenien me qera te ambienteve perkatese per tu perdorur si zyra administrative nga Zyra Vendore Arsimore Roskovec.

Ky projekt-vendim u sqarua nga Kryetarja e bashkise dhe Dr.Juridike.Kryetari u ben me dije se sot na ka ardhur nje projektvendim shtese te cilin une e lash per ne fund.Hidhet ne votim per ta shtuar ne rendin e dites sot dhe miratohet unanimitisht me 19 vota pro shtimi i ketij projekti per miratim.Ky projekt ka te beje me dhenien me qera te ambienteve perkatese per tu perdorur si zyra administrative nga Zyra Vendore Arsimore Roskovec.Dr.Juridike sqaron projektin e ambienteve qe do jepen me qera ZVA Roskovec.Do jepen 2 zyra ne katin e pare te objektit 3 katesh social ne pronesi te Bashkise Roskovec.Nuk ka pyetje.Hidhet ne votim projekti i dhenies me qera dhe miratohet unanimitisht me 19 vota pro,3/5 +6 vota pro.

14.Diskutim dhe komente te qytetareve.

Qytetari Durim Bakaj ngre shqetesimin se ne Mbers nuk ka infermier dhe as doktor.Ne Mbers jane disa familje qe nuk marrin asgje,atyre nuk u jep njeri.Nje nga ato familje eshte ajo e Fecorr Korones,ka dhe te tjera.Kryetarja thote se u sqarua ky problem ne fillim te mbledhjes,emrat qe nuk perfitojne nga vendimi qeverise,do verifikohen nga shtabi i emergjencave.D.Bakaj pyet per prioritetet qe jane thene si:uji i pijshem,rruget e fshatrave dhe sherbimin e pastrimit,ne lagjen time ne i djegim vet plehrat.Kryetarja sqaron se rruget jane nderprere nga epidemia,per pastrimin do permiresohet.Aleksandri-tek lagja ime pjesen e gjelberimit mund ta menaxhojme vet si lagje?Kryetarja-do vij ta shoh vet dhe do tu them cfare te beni.Elmazi-falenderim per punetoret e pastrimit dhe propozon tu jepet shperblim financiar per punen e tyre ne kete shtate te veshtire.Elmazi-eshte nje objekt 2 katesh tek Petrefi i Hajdarit,te vihen nja 3 stola per femijet.Viktori-shqetesim per tokat tek ura Jagodine,kane problem me bagetin se futen ne tokat e tyre.Mbyllet mbledhja.

**Sekretar**

**Arlinda Hajdini**

**Kryetar**

**Kadri Hyska**

